


SHFK “ASDRENI” fshati Glllogjë



RAPORT

Nga vetevaluimi i kryer nga SHFK “ASDRENI” – f. Glllogjë

Në bazë të nenit 129 të Ligjit për arsimin fillor (Gazeta Zyrtare e RMV nr. 161/19 dhe vendimit të Këshillit të Shkollës Nr. 04-122/3 datë 21.08.2023, drejtori i SHFK "ASDRENI" – f. Gllogjë solli vendim për emërimin e anëtarëve për realizimin e vetëvlerësimit për vitet akademike 2021/22 dhe 2022/23

RAPORT

RRETH VETEVALUIMIT TË KRYER

mbi punën e shkollës

për vitin akademik 2021/2022 dhe 2022/2023

Pas përfundimit të vitit akademik 2022/23,, SHFK “Asdreni” f. Gllogjë u pregadit vetevaluimi i shkollës i cili është ligjërish i detyrueshëm. Me përfundimin e vetevaluimit, komisioni i shkollës i formuar nga këshilli i shkollës me propozim të drejtorit të shkollës e ka pregaditur raportin të cilin do ta prezantojë para këshillit të shkollës, drejtorit dhe themeluesit.

Komisioni për vetevaluim është i përbërë nga pesë antarë:

- Sabiha Musi Ismaili – Psikologe
- Sheqibe Emimi – Pedagoge
- Selim Jonuzi – ars.lëndor
- Shpresa Adili – ars.klasor
- Mirsat Esati – prind.

Për pregaditjen e Vetevaluimit të shkollës jemi bazuar në Ligjin për Arsimit Fillor, treguesit e cilësisë së punës së shkollës përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Qëllimi i Vetevaluimit është analiza dhe rishikimi i të gjitha fushave të funksionimit të shkollës për të marrë një pasqyrë për cilësinë e funksionimit të shkollës, progresin dhe arritjet e shkollës, pikat e forta dhe të dobëta për të cilat në vijim propozohen masat për tejkalimin e tyre. Sigurisht, dobësitë e perceptuara do të motivojnë të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) që të investojnë kapacitetet e tyre dhe përdorin burimet ekzistuese për përmirësim të kushteve dhe standardeve në shkollë. Në këtë mënyrë do të kontribuojmë plotësisht në zbatimin më cilësor të procesit edukativo arsimor. Vetevaluimi dhe fushat prioritare të veprimtimit për avancimin dhe modernizimin e aktiviteteteve kurrikulare dhe jashtëshkollore. Qëllimi i përbashkët i të gjitha subjekteve në shkollë është se anët e dobëta janë në numër më të vogël, dhe ato të forta janë në rritje. Vetevaluimi është kryer në bazë të treguesve të përcaktuar për shtatë fushat kryesore të veprimtarisë së shkollës, përkatësisht:

1. Planet dhe programet mësimore
2. Të arriturat e nxënësve
3. Mësimi dhe procesi edukativo arsimor
4. Kujdesi për nxënësit
5. Klima në shkollë
6. Resurset
7. Udhëheqësia dhe krijimi i politikës

Çdo fushë kyçe u vlerësua në një numër treguesish për cilësinë, dhe çdo tregues shpjegohet përmes temave që lidhen me aktivitete e veçanta që janë ndjekur në shkollë. Për informacion dhe të dhëna për cilësinë e aktiviteteteve nga të gjitha fushat është marrë nëpërmjet monitorimit të të dhënave dhe dokumentacionit pedagogjik, monitorimi i veprimtarive mësimore dhe të tjera jashtëshkollore, burimet me të cilat shkolla ka biseda, vëzhgime, analiza, raporte të tjera që janë shfrytëzuar si burime të të dhënave. Nga Vetevaluimi i shkollës do të veçojmë pikat kryesore të forta, dobësitë si propozim për masa për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, dmth. të ardhmen aktivitetet dhe prioritetet.

Në fushën 1. – Planet dhe programet mësimore

Pikat kryesore të forta

- Shkolla në përgjithësi bën realizimin e programeve mësimore të përcaktuara nga MASH , me sukses bën përgatitjen e tyre në bazë të kushteve të shkollës si në infrastrukturë dhe mjeteve pamore-auditive.
- Arsimitarët , nxënësit, prindërit njihen me kohë për programet mesimore në ç’do fillim viti,
- Planet dhe programet mësimore janë të përshtateshme me nevojat e mesit lokal,
- Nga ana e drejtorit dhe shërbimit profesional në menyrë permanente bëhet kontrollimi i përgatitjeve ditore të arsimatrëve ,
- Nuk mungon ndihma e nevojshme nga ana e shërbimit pedagogjik në përgatitjet e planifikimeve vjetore të arsimtareve, shkollës, të aktiveve profesionale etj,
- Arsimatrët dorezojnë për ç’do muaj planifikimet tematike për ç’do lëndë mësimore,
- Në planifikimin vjetorë - mujorë, dhe ditorë të gjithë arsimatrët kanë të integruara format dhe metodat bashkëkohore,
- Arsimtarët kanë të planifikuara përmbajtjet mësimore me TIK.
- Në planet e tyre mesimore arsimatrët kanë të integruar edhe përmbajtjet të cilët janë në kuadër të EKO-standardeve .
- Shkolla u jep rëndësi të madhe nxënësve në përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore prej kl. VI-IX nxënësit këtë përzgjedhje të lëndëve e bëjnë përmes anketës.

Pikat kryesore të dobëta

- Plan programi mesimorë zhvillohet në mungesë të mjeteve të duhura mësimore.
- Mësuesit nuk kanë burime të mjaftueshme mësimore për ta realizuar programin e Kembrixhit në matematikë dhe shkencë
- Realizimi i procesit edukativo arsimorë nga kohë pandemie her pas herë realizohej me vështirësi.

Aktivitetet e ardhshme - prioritetet

- *Aktivitetet jashtëmësimore të realizohen në bazë të plan-programit të shkollës*
- *Bashkëpunimi i shkollës me mjedisin të jetë në nivel të duhur*
- *Të shpërblehen arsimtarët dhe nxënësit që kanë sukses në punë*

Në fushën 2. - Arritjet e nxënësve

Pikat kryesore të forta:

- Ekziston një bazë e madhe e të dhënave për vitet e kaluara;
- Çdo tremujor bëhet një analizë e suksesit dhe sjelljes së nxënësve dhe bëhet krahasimi me tremujorin e vitit të kaluar dhe me vitin aktualshkollor;
- Numri më i madh i nxënësve kanë sjellje shembullore;
- Numri i mungesave të arsyeshme dhe numri i mungesave të arsyeshme kontrollohen;
- Kriteri për vlerësimin e sjelljes zbatohet në mënyrë konsistente;
- Është i kontrolluar numri i nxënësve që braktisin shkollën;
- Në shkollë zhvillohen shumë gara në fusha të ndryshme dhe gjithçka është e arritur me rezultate të shkëlqyera;
- Shkolla merr pjesë në një numër të madh projektesh dhe aktivitete të ndryshme kulturore e sportive si dhe manifestime;
- Prindërit informohen menjëherë për arritjet e fëmijëve të tyre (SMS dhe ditari elektronik);

Pikat e dobëta

- *Një numër i madh mungesash (të arsyeshme dhe të paarsyeshme);

Aktivitetet e ardhshme – prioritetet

*Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, realizimi i orëve plotësuese dhe shtuese (realizimi i programit për punë me fëmijë me vështirësi në të nxënë nga BRO);

*Ulja e numrit të mungesave të arsyeshme dhe të paarsyeshme;

Në fushën 3. – Mësimi dhe procesi edukativo arsimor

Pikat kryesore të forta

- Kuadër mësimor i kualifikuar
 - Në tërësi përpunohen planet globale, tematike, procesuale dhe ditore. (TIK-u dhe EKO STANDARDET)
 - Shkolla ka një kabinet informatike (tabele interaktive), llaptopa për mësimdhënësit dhe rrjet interneti
 - Mësimi zhvillohet me mënyra bashkëkohore me projektor (sipas orarit që e kanë të planifikuar me TIK)
 - Rregullisht ndiqet suksesi dhe sjellja e nxënësve
 - Trajtim i njëjtë për të gjithë nxënësit
- Mbajtja e shumë trajnimeve, seminareve sidomos online në periudhën e pandemisë.

Pikat kryesore të dobëta

- Mungesa e bashkëpunimit mësimdhënës-prind për ritjen e mësimxënies së tyre.
- Realizimi për format e mësimdhënies në shkollë realizohet me vështirësi sepse nuk ka mjete të mjaftueshme për lëndët Kimi, Fizikë, Biologji.
- Mësimdhënia në lëndën kulturë fizike nuk mbahet e plotë për shkak të mungesës së mjeteve në sale sidomos gjatë stinës së dimrit.
- Realizimi i mësimin nga distance ka shumë mangës, pasojat e së cilës do të vërehen ndoshta për një kohë shumë të shkurtër.

Aktivitetet e ardhshme – prioritetet

- Organizimi i seminareve për mësimdhënësit në fillim të vitit shkollor.
- Të stimulohen nxënësit më të mirë për punë të mëtutjeshme.
- Rregullimi i sallës së sportit;

Në fushën 4. - KUJDESI PËR NXËNËSIT

Pikat kryesore të forta

- ♣ Nxënësit janë të edukuar, të drejtuar drejt sjelljes jo të dhunshme;
- ♣ Pajtueshmëria me protokollet Covid është realizuar në mënyrë të përpiktë;
- ♣ Në orët mësimore nxënësve ju ligjërohet edhe për lëndët narkotike dhe pasojat që i shkaktojnë;
- ♣ Organizohet ndihmë dhe mbështetje për nxënësit me raste sociale;
- ♣ Tregohet kujdesi për nxënësit me nevoja të veçanta;
- ♣ Higjiena është në një nivel të lakmueshëm;
- ♣ Ligjërata për sëmundjet infektive, shfaqjen dhe parandalimin e tyre;
- ♣ Organizohet ligjëratë për orientimin profesional;
- ♣ Stafi është i përkushtuar ndaj nxënësve në dhënien e çdo ndihme;
- ♣ Mbajtja e shënimeve të rregullta të përparimit të nxënësve;
- ♣ Përgatitja e rregullt e raporteve për progresin e nxënësve në nivel shkolle;
 - ♣ Ka bashkëpunim mes mësuesve dhe prindërve i cili bazohet në tashmë program i përgatitur për punë dhe aktivitete gjatë vitit shkollor;
 - ♣ Prindërit përfshihen në jetën e shkollës përmes formave nga më të ndryshmet dhe aktivitete të tilla si pjesëmarrja në projekte, mbledhjet e prindërve të mbajtura rregullisht;
- ♣ Mësuesit dhe shërbimi profesional informojnë rregullisht prindërit dhe ekziston bashkëpunim i vazhdueshëm dhe i ndërsjelltë;
 - ♣ Bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Prindërve dhe shkollës është i përhershëm;
- ♣ Ka bashkëpunim të hapur dhe të ndërsjellë me komunitetin lokal dhe kryetarin e komunës;
- ♣ Shkolla bashkëpunon me institucione të tjera arsimore në Republikën e Maqedonisë;

Pikat kryesore të dobëta

* Mësuesit nuk janë të trajnuar për të punuar me nxënës me nevoja të veçanta - mësuesit e klasës dhe lëndës;

Aktivitetet e ardhshme - prioritetet

*Organizimi i trajnimeve për mësuesit për të punuar me nxënës me nevoja të veçanta - Për mësuesit klasorë dhe lëndorë;

Në fushën 5. – Klima në shkollë

Pikat kryesore të forta

- Shkolla ka kritere për vlerësimin e nxënësve;
- Shkolla e analizon dhe e respekton diversitetin etnik, kulturor dhe religjioz në shkollë;
- Shkolla në mënyrë sistematike e përcjell, e krahason dhe e analizon gjendjen me suksesin dhe arritjet e nxënësve;
- Shkolla posedon të dhënat lidhur me arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.
- Prindërit lajmërohen në kohë lidhur me arritjet e nxënësve;
- Bashkëpunim i ndërsjellë ndërmjet shkollës dhe MASH, BZHA, qeverisjes lokale;
- Nxënësit me aftësi të veçanta, gjini dhe prejardhje etnike respektohen reciprokisht, bashkëpunojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin;
- Ekziston një mbështetje e ndërsjellë dhe një klimë e hapjes për bashkëpunim midis nxënësive dhe mësimitdhënësve;
- Shkolla kapërcen me sukses problemet që lidhen me disiplinën dhe sjelljen e nxënësve;
- Shkolla ka përgatitur një Kod të Sjelljes për mësimitdhënësit dhe nxënësit;
- Hapja maksimale e shkollës për bashkëpunim me prindërit dhe bashkësinë lokale;

Pikat kryesore të dobëta

- ❖ Të inkurajojë nxënësit për pjesëmarrje më të madhe në garat e dijes;
- ❖ Të zbatohen më shumë aktivitete për bashkëpunim ndëretnik dhe multikulturor;

Aktivitetet e ardhshme - prioritetet

- ❖ Të inkurajojë nxënësit për pjesëmarrje më të madhe në garat e dijes;

Në fushën 6. –Resurset

Pikat kryesore të forta

- Shkolla posedon kabinet për informatikë të pajisur me kompjuter dhe tabelë interaktive ku nxënësit janë të kyçur drejtpërdrejtë në internet.
- Shkolla posedon kabinet të gjuhës angleze të pajisur me kompjuterë, smart table – dërrasë e mençur, printer dhe shum mjete të tjera të rëndësishme për zhvillimin e orës mësimore në këtë lëndë.
- Kabineti i shkencave natyrore ku realizohen orët e kimisë, fizikës dhe të biologjisë sidomos orëet që kanë të bëjnë me eksperimente;
- Biblioteka e shkollës i plotëson kushtet për kërkesat e nxënësve;
- Mësonjëtorët deri diku kanë kushte të mira për organizimin e mësimit, disa klasë janë të pajisur me tabela të bardha si dhe shkolla ka disa projektorë me të cilat shërbhen të gjithë arsimtarët;
- Shkolla ka kapacitet intelektual për ta ndjekur punën e praktikantëve të cilëve u caktohet mentor për ta ndjekur punën e tyre;
- Shkolla jonë ka një kuadër të kualifikuar edhe atë 4 me shkollim të lartë, ndërsa të tjerët me fakultet dhe një mësimdhënëse është magjistër e mësimdhënies së gjuhës angleze;

Pikat kryesore të dobëta

- Uji i shkollës për pije nuk është i cilësisë së lartë dhe është i ndaluar për tu konsumuar;
- Orët e arsimit fizik gjatë stinës së dimrit nuk mbahen në sallën e sportit për shkak të mungesës së nxemjes në sallë;

Aktivitetet e ardhshme - prioritetet

- ❖ Riparim i sallës për arsim fizik;
- ❖ Fasadimi i shkollës nga jashtë sepse kjo mungesë e fasadimit sjell harxhime të mëdhaja gjatë stinës së dimrit (naftë);
- ❖ Sigurimi edhe i projektorëve për secilën klasë për zhvillim të mësimit me mjete audio-vizuale;

Në fushën 7 - Udhëheqësia dhe krijimi i politikës

Pikat kryesore të forta

- + Shkolla ka partneritete në nivel lokal, rajonal dhe komunal;
- + Planifikimi dhe zbatimi i rregullt i përmbajtjes së projekteve të shumta;
- + Shënimi i rregullt i datave më të rëndësishme për shkollën dhe nxënësit me festa të përshtatshme dhe aktivitete të përshtatshme për atë rast;
- + Prindërit marrin raporte të rregullta me shkrim të progresit e fëmijëve të tyre për çdo lëndë (fletë evidentuese);
- + Idetë dhe sugjerimet e prindërve shqyrtohen dhe miratohen nga bordi i shkollës brenda mundësive;

Pikat kryesore të dobëta

- + Bashkëpunim më i madh me shkollat tjera fillore nga komuna;

Aktivitetet e ardhshme - prioritetet

- + Përfshirja më e madhe e prindërve në punëtoritë dhe projektet shkollore aktivitetet;
- + Organizimi i aktiviteteve eko në shkollë dhe në rrethinë;

Anëtarët dhe komisioni për vetevaluim:

1. Sabiha Musi Ismaili – Psikologe
2. Sheqibe Emini – Pedagoge
3. Selim Jonuzi – ars.lëndor
4. Shpresa Adili – ars.klasor
5. Mirsat Esati – prind.

Drejtori: ud. Enver Ramadani